


# RAPORTIMI PËR DHUNËN NË FAMILJE



# Çka është dhuna në familje?

Nuk ka ndonjë përkufizim universal të dhunës në familje, megjithatë, në Kosovë përkufizohet si vijon: veprim apo mosveprim i qëllimshëm që rezulton me abuzim, kur kryhet nga një person që është apo ka qenë në marrëdhënie familjare<sup>1</sup> me viktimën, siç është:

**Keqtrajtimi fizik:** përdorimi i çfarëdo lloji të forcës fizike; çdo veprim tjetër që mund të shkaktojë apo kanosë të shkaktojë dhembje fizike; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesa e viktimës; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit; rrëmbimi. Keqtrajtimi i tillë përfshin goditjen, djegien, goditjen me shuplakë, si dhe prerjen e viktimave.

**Keqtrajtimi psikologjik:** ushtrimi i trysnisë psikologjike; çdo veprim që mund të shkaktojë apo të kanosë të shkaktojë dhembje psikologjike; provokimi i ndjenjës së frikës, rrezikut personal, apo kërcënimit të dinjitetit; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues, si dhe forma të tjera të frikësimit të dhunshëm; sjellja e përsëritur me qëllim të degradimit të viktimës; kufizimi i paligjshëm i lirisë së lëvizjes së viktimës, shpesh me shprehje të xhelozisë së tepërt dhe kontrollit; shkaktimi i ndjenjës së frikës për mirëqenien emocionale.

**Keqtrajtimi seksual:** Veprat seksuale pa pëlqim si dhe keqtrajtimi seksual, si përdhunimi dhe sulmi seksual.

**Keqtrajtimi ekonomik:** përjashtimi nga ekonomia e përbashkët familjare, dëmtimi i pronës, apo shkatërrimi apo kërcënimi për ta shkatërruar atë; shkaktimi i ndjenjës së frikës për mirëqenien ekonomike. Kërcënimet dhe detyrimi shpesh ndërliken me fëmijët.

*Viktima e dhunës në familje është person që vuan nga një akt i dhunës në familje, ndërsa kryesi i dhunës në familje është person që kryen aktin e dhunës në familje.*<sup>2</sup> Ekzistojnë **disa karakteristika** që ndihmojnë në identifikim të kryesve të dhunës në familje, duke përfshirë pretendimin që është viktimë vetë si dhe fajësimin e viktimës së vërtetë për keqtrajtimin, ndjenjën e të pasurit të drejtë për të përdorur taktika detyruese dhe për të keqtrajtuar partnerin, xhelozinë e skajshme dhe sjelljen kontrolluese, krijimin e pritjeve jo realiste apo kërkesave ndaj partnerit, duke përdorur xhelozinë si arsytim për veprimet e tyre, ku këta shpesh duken mjaft të afërt, të qetë, të butë, e edhe të dashur. Personat me çrregullime mendore dhe personat e varur nga narkotikët dhe substancat tjera psikotropike shpesh janë kryes të veprave që lidhen me dhunën në familje.

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 03/L-182 për mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 2.1(1.1): E definon si të tillë mes personave që janë/kanë qenë: janë apo kanë qenë të fejuar, janë apo kanë qenë të martuar; janë apo kanë qenë në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët, si dhe përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie, duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezeta, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët, janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare; <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

<sup>2</sup> Katalogu i Këshillave dhe ndihmës për viktimat e dhunës në familje, OSBE, faqe 2: <https://www.osce.org/kosovo/88708?download=true>

# Identifikimi i shenjave të abuzimit

**Identifikimi i viktimës** së dhunës në familje nuk është gjithmonë i lehtë, megjithatë ka disa karakteristika të caktuara që zakonisht vërehen tek viktimat e dhunës në familje.

**Çështjet e shëndetit mendor:** Viktimat e dhunës në familje zakonisht vuajnë nga ankthet, mendimet vetëvrasëse, depresioni, vetëbesimi i dobët, si dhe problemet me droga apo alkool.

**Ndryshimet në personalitet, sjellje e shoqërim:** Ndodh tejet shpesh që viktimat të humbin interesimin për aktivitete të përditshme, si dhe të duken të heshtura e të tërhequra; si dhe mund të duken në ankth apo nervozë kur janë larg nga keqtrajtuesi. Ndodh shpesh që viktimat e dhunës në familje të izoloohen nga miqtë dhe familjarët, shpesh duke anuluar planet në momentin e fundit, ose duke u vonuar pa kurrfarë shpjegimi. Viktimat gjithashtu zakonisht janë të tërhequra për së tepërmi në lidhje me jetën dhe raportet personale.

**Marrëdhënia me partnerin e tyre:** Sjellja kontrolluese është shpesh shenjë e keqtrajtimit, si dhe viktimat shpesh duhet të vazhdojnë të përgjigjen në telefon si dhe t'i mbajnë partnerët të informuar mbi atë se ku janë, çfarë janë duke bërë, me kë janë, si dhe kur do të kthehen në shtëpi.

**Fëmijët viktimë:** Fëmijët viktimë të keqtrajtimit mund të duken të frikësuar, të turpshëm, me ankth, si dhe shpesh skajshmërisht të sjellshëm në prani të keqtrajtuesit. Kur ka abuzim ekonomik, nuk është e pazakonshme për viktimat që të kenë tepër pak para të vetat, si dhe mund të mos kenë llogari të tyre bankare apo kartelë kreditore, pasi që shumë abuzues kontrollojnë financat e familjarëve të tyre.

**Lëndimet fizike** që ndërlihen me dhunën në familje: Buzët e çara, sytë e nxirë, enjtje në fytyrë, qafë e duar, si dhe kyçe dore të përdredhura. Viktimat e dhunës në familje shpesh kanë shpjegime joreale e jokonsistente për lëndimet e tyre, që shpesh fshihen me grim, si dhe shpesh nënvlerësojnë seriozitetin e tyre.

Dhuna në familje dhe keqtrajtimi i partnerit ka të bëjë me pushtetin dhe kontrollin dhe pasi që braktisja përbën nivel tejet të lartë të rrezikshmërisë për viktimat, është me rëndësi të merret parasysh me kujdes se si të ndihmohen më së miri viktimat. Spitalet dhe shkollat janë posaçërisht akterë të rëndësishëm në dhunën në familje dhe mund të shërbejnë si vende të dobishme ku viktimat e dhunës në familje mund të identifikohen e pastaj të referohen te policia apo strehimoret.<sup>3</sup> Ofrimi i informatave për shenjat e abuzimit mund të jenë mjet efektiv për mobilizimin e njerëzve që të njohin e të raportojnë abuzimet, qoftë ndaj tyre vetë apo ndaj të tjerëve dhe për të fuqizuar viktimat që të marrin vetë vendimet. Gazetarët duhet të theksojnë që viktimat e dhunës në familje duhet të gëzojnë përkrahje e inkurajim dhe është me rëndësi që viktimat të mos detyrohen të ndjehen të gjykuara apo nën trysni, pasi që vetë kërkimi i ndihmës dhe këshillave kërkon trimëri të madhe nga viktimat.

<sup>3</sup> OSBE, Katalogu i këshillave dhe ndihmës për viktimat e dhunës në familje, <https://www.osce.org/kosovo/88708?download=true>

# Mitet e shpeshta për dhunën në familje

Ekzistojnë disa mite e keqkuptime të zakonshme tek popullata në lidhje me dhunën në familje, sidomos për gratë dhe komunitetet e ndryshme, ndërsa mbulimi medial mundet shpesh të mbështesë dhe të nxisë disa prej këtyre miteve.

**Mitet e zakonshme** janë, por nuk kufizohen vetëm në këto:

*Dhuna në familje është pasojë e abuzimit të substancave, stresit, varfërisë, dështimit në martesë.*

- Kjo është e pasaktë: pasi që nënkupton që ata që përjetojnë ndonjëherë nga ato që u përmenden më lart ushtrojnë dhunë në familje, gjë që përforcon stereotipat negativë. Për më tepër, kjo i jep arsyetim keqtrajtuesve, që ushtrojnë dhunë në familje qëllimisht duke përdorur pushtetin dhe kontrollin.

*Dhuna që ndodh brenda shtëpisë shpesh konsiderohet si çështje private dhe është më pak serioze sesa dhuna që ndodh në publik.*

- Kjo është e pasaktë: dhunë në shtëpi është së paku po aq, në mos edhe më shumë, serioze dhe dëmtuese sa format tjera të dhunës, dhe prapë është vepër penale.

*Dhuna në familje shkaktohet nga problemet me menaxhimin e zemërimit.*

- Kjo është e pasaktë: Dhuna në familje përdoret nga ai/ajo që ka kontroll mbi zemërimin e vet, si dhe përdor një sjellje të caktuar për të shtrirë pushtetin mbi tjetrin, pra është vendim i vetëdijshëm që merret nga vetë keqtrajtuesi.

*Dhuna në familje është pasojë e problemeve në marrëdhënie/familje.*

- Kjo është e pasaktë: Ky mit e trivializon (nënvlerëson) dhunën në familje si dhe nënkupton që edhe viktimja ka pasur faj. Gazetarët duhet ta bëjnë të qartë që kryesi nuk mund të arsyetohet në veprimet e tij dhe duhet të nënvizojnë që përgjegjësia është vetëm e kryerësit.

*Vendimi për të mos e braktisur kryesin shpesh konsiderohet zgjedhje e menduar dhe strategjike e viktimës.*

- Kjo është e pasaktë: Ikja nga mjedisi i dhunës në familje përbën rrezik të madh për viktimën, mund të shpjerë edhe tek humbja e të ardhurave/punësimit/vendbanimit/miqësisë/mbështetjes, dhe këto rreziqe rriten edhe më shumë kur viktimja ka fëmijë. Ikja nga ai mjedis mund të sjellë edhe rritje të rrezikut të sulmeve e kërcënimeve të tjera. Vënia e fokusit tek pyetja pse viktimja nuk ka ikur është fajësim i viktimës, si dhe e heq përqendrimin nga veprimet e keqtrajtuesit.

# 1. Kuadri ligjor

## 1.1 Standardet ndërkombëtare

Dhuna në familje njihet në kornizën ligjore ndërkombëtare si shkelje e tri të drejtave primare të njeriut:

- **E drejta për jetë dhe siguri të personit** – Neni 3 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), neni 6 dhe neni 9, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR);
- **E drejta për barazi** - dhuna me bazë gjinore është njohur si formë e diskriminimit nga Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW);<sup>4</sup>
- **Ndalimi i torturës** - Komiteti kundër torturës ka konfirmuar që dhuna në familje është formë e torturës.<sup>5</sup>

*“Përkufizimi i diskriminimit përfshin dhunën me bazë gjinore, [...] të ushtruar ndaj një gruaje për shkak se është grua, ose që prekë gratë në masë joproporcionale. Ky përfshin aktet që shkaktojnë dëm apo vuajtje fizike, mendore apo seksuale, kanosjet për ato akte, detyrimin dhe mënyrat tjera të privimit të lirisë”.*

*“Dhuna në familje është një prej formave më tinzare të dhunës ndaj grave [...] ku përfshihen rrahjet, përdhunimet, format tjera të sulmeve seksuale, mendore dhe format tjera të dhunës, të cilat nxiten nga pikëpamjet tradicionale. Mungesa e pavarësisë ekonomike i shtyn shumë gra të vazhdojnë të qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme. [...]Këto forma të dhunës vënë shëndetin e grave në rrezik, dhe e dobësojnë aftësinë e tyre për të marrë pjesë në jetën familjare dhe jetën publike në baza të barabarta”.*

## 1.2 Kuadri ligjor për dhunën në familje në Kosovë

Institucionet e Kosovës dhe ofruesit e shërbimeve kanë për obligim të parandalojnë dhunën në familje, të referojnë rastet e dhunës në familje te Policia e Kosovës, të mbrojnë viktimat e dhunës në familje, të hetojnë aktet e dhunës dhe të ndjekin penalisht e të dënojnë kryesit.<sup>6</sup>

---

<sup>4</sup> Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 19 nga Komiteti për eliminimin e diskriminimit ndaj gruas (1992) si dhe Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj grave (1993): <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm>

<sup>5</sup> Komiteti CAT, Komenti i përgjithshëm Nr. 3: [https://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/qc/cat-c-qc-3\\_en.pdf](https://www2.ohchr.org/english/bodies/cat/docs/qc/cat-c-qc-3_en.pdf)

<sup>6</sup> Këto institucione e ofruen shërbimesh janë: Policia e Kosovës, prokuroritë, gjykatat, Koordinatori i Kosovës për mbrojtje nga dhuna në familje/zëvendësministri i drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe qendrat për punë sociale, zyrat për mbrojtje dhe avokim për viktimat/mbrojtësit e viktimave, linjat e ndihmës, institucionet shëndetësore, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë/drejtoritë e arsimit, shkollat, Avokati i Popullit/Departamenti për barazi gjinore, strehimoret, shoqëria civile

## 1.2.1 Procedura penale

Dispozitat që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga dhuna në familje në Kosovë janë paraparë me Kodin Penal, Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë për të Mituri dhe Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Dhuna në familje nuk është vepër penale e posaçme në Kodin Penal<sup>7</sup> dhe viktimat nuk mbajnë përgjegjësi para ligjit për mosraportim të përgatitjes së veprave penale,<sup>8</sup> dhe për ofrimin e ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprave penale.<sup>9</sup>

Çka do të thotë kjo? – Në rast se dhuna në familje ndodh dhe raportohet, kryesi i veprës potencialisht do të ngarkohet për vepra tjera penale sipas Kodit Penal, si vijon:

- *Neni 185 - Kanosja;*
- *Neni 186 - Ngacmimi;*
- *Neni 187 - Sulmi;*
- *Neni 188 - Lëndimet e lehta trupore;*
- *Neni 189 - Lëndimet e rënda trupore;*
- *Neni 196 - Privimi i kundërligjshëm i lirisë;*
- *Neni 199 - Tortura;*
- *Neni 230 - Përdhunimi;*
- *Neni 232 - Sulmi seksual;*
- *Neni 233 - Degradimi i integritetit seksual;*
- *Neni 243 - Marrëdhëniet seksuale brenda familjes;*
- *Neni 385 - Moslajmërimi i përgatitjes së veprave penale*
- *Neni 388 - Dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprave penale.*

Neni 74 i Kodit Penal parasheh Rregullat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimeve, duke përfshirë dispozitat e lidhura me dhunën në familje, siç është nëse vepra penale është kryer në mënyrë posaçërisht mizore,<sup>10</sup> si dhe prania e dhunës ose kanosjes me dhunë në kryerjen e veprës penale.<sup>11</sup> Neni 24 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje përcakton përgjegjësitë e Policisë së Kosovës, duke përfshirë arrestimin e kryesit të dyshuar sipas ligjit, si dhe përdorimin e mjeteve të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën e mëtutjeshme.<sup>12</sup>

---

<sup>7</sup> Kuvendi i Kosovës është në proces të miratimit të Kodit të ri Penal në shqyrtim, i cili do të përfshijë edhe dhunën në familje si vepër të posaçme, shih Projektligjin [http://ligjet.assembly-kosova.org/Uploads/Data/Documents/74ProjektKodiPenaliKosoves\\_8FdcPc8D4YT.pdf](http://ligjet.assembly-kosova.org/Uploads/Data/Documents/74ProjektKodiPenaliKosoves_8FdcPc8D4YT.pdf) (neni 248)

<sup>8</sup> Kodi Penal, neni 385: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>9</sup> Kodi Penal, neni 388: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>10</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 74(2.9):

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>11</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 74(2.3):

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>12</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 24: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/2010-182-eng.pdf>



Ekzistojnë disa aspekte që gazetarët duhet që gjithsesi t'i mbulojnë kur raportojnë mbi procedurat penale të dhunës në familje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në këto;

- *Periodha kohore prej raportimit të keqtrajtimit nga viktimat tek policia deri tek veprimi i ndërmarrë;*
- *Koha që është dashur për të gjetur dhe arrestuar kryesin;*
- *A e ka raportuar më herët rastin viktimë në polici? A është marrë seriozisht më herët?*
- *A ka baraspeshim burra/gra në stacionin policor?*
- *A i është ofruar viktimës strehimi dhe/ose mbrojtja policore, përfshirë edhe për fëmijët e saj?*
- *Nëse ka pasur pretendime për dhunë seksuale, është zbatuar procedura e duhur atëherë kur është raportuar?*
- *A janë marrë seriozisht pretendimet e viktimës?*
- *A është informuar viktimë për të drejtat e saj?*
- *A është lëshuar urdhri mbrojtës për viktimën, nga policia apo mbrojtësit e viktimave?*
- *A ka kryesi histori të dhunës?*
- *A ka shërbime të mjaftueshme të përkthimit në dispozicion, nëse viktimë është nga komunitet joshumicë?*
- *A është trajtuar viktimë me respekt dhe ndjeshmëri?*
- *I janë ofruar viktimës shërbime mjekësore?*
- *Sa respektohen të drejtat e njeriut të pandehurit? (Shih pikën: 4.3. E drejta për gjykim të drejtë)*
- *A trajtohen të gjitha elementet e abuzimit, nëse rasti arrin në gjykim? – për shembull, rasti në gjykatë mund të mos trajtojë aspektin e abuzimit emocional në atë rast*
- *Ka pasur dëshmitarë?*
- *Gazetarët duhet të trajtojnë nëse gjykata e përshkruan krimin si “dhunë në familje” apo thjesht si “sulum”, për shembull.*

### 1.3 Qasja në informata të gjykatës

Liria e shprehjes përfshin të drejtën e qasjes në informatat në dispozicion të organeve publike, përfshirë këtu gjykatat, përveç të dhënave të ndjeshme.<sup>13</sup> Kur kërkojnë qasje, gazetari nuk duhet të detyrohet të paraqesë arsyet e kërkesës për qasje. Informatat për dhunën në familje kategorizohen si “të dhëna të ndjeshme”, si dhe duhet të mbrohen e klasifikohen veçanërisht. Kështu, të dhënat personale që lidhen me vendimet dhe veprat penale duhen proceduar vetëm nën kontrollin e autoritetit zyrtar, duke zbatuar masat përkatëse të sigurisë. Të dhënat e ndjeshme personale, si identiteti i viktimës, mund të ofrohen vetëm në rrethana të caktuara, siç është interesi i madh publik.<sup>14</sup>

<sup>13</sup> Kuadri ligjor i Kosovës, Neni 41(1): <http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

<sup>14</sup> Neni 6(1) 1.8: <https://www.afapdp.org/wp-content/uploads/2012/01/Law-on-Personal-Data-Protection-Kosovo.pdf>

Seancat gjyqësore penale në Kosovë duhet të kenë procesverbal me shkrim të procedurës, sipas nenit 315 të Kodit të Procedurës Penale.<sup>15</sup> Kjo e drejtë e qasjes në informata kufizohet me ligj kryesisht për njërin nga këto arsye: Privatësia, sekretet afariste, apo klasifikimi i sigurisë.<sup>16</sup> Pasi të ketë filluar seanca, aktgjykimi i gjykatës publikohet, përveç kur publikimi i tillë do të rrezikonte një sekret zyrtar, privatësinë e personave apo moralin shoqëror.

## 1.4 Prania në seancat gjyqësore penale

Seancat gjyqësore penale në Kosovë, në parim, janë të hapura për mediat dhe publikun, ndërsa gazetarët kanë të drejtë të ndjekin seancat kryesore gjyqësore në Kosovë për të ruajtur transparencën dhe llogaridhënien e drejtësisë. Gjykatat duhet t'i vënë në dispozicion të gazetarëve oraret e seancave gjyqësore, ndërsa kur këto informata nuk janë në dispozicion, gazetarët duhet të kontaktojnë zyrtarin përkatës të informimit publik, ose gjykatën përkatëse dhe të kërkojnë që informatat e tilla të vihen në dispozicion.<sup>17</sup> Gjykata ka kompetenca që të rregullojë procedurat e veta dhe në rrethana të jashtëzakonshme, mund të mbajë seanca gjyqësore, ose pjesë të tyre, të mbyllura. Neni 294 i Kodit të Procedurës Penale parasheh arsyet për të cilat publiku dhe shtypi mund të përjashtohen nga procedurat gjyqësore.<sup>18</sup>

Këto arsye janë, mes tjerash:

- *Ruajtja e fshehtësisë zyrtare;*
- *Ruajtja e konfidencialitetit të informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale që do të rrezikoheshin nga shqyrtimi publik;*
- *Ruajtja e rendit dhe respektimi i ligjit;*
- *Mbrojtja e jetës personale ose familjare të të akuzuarit, të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë;*
- *Mbrojtja e interesave të fëmijëve; ose*
- *Mbrojtja e palëve të dëmtuara, dëshmitarëve bashkëpunues, apo dëshmitarëve të tjerë të paraparë me Kodin penal.*

Nëse gjykata përjashton mediat dhe publikun nga gjykimi, ajo duhet të ofrojë arsyetim me shkrim për këtë vendim.<sup>19</sup> Të gjitha seancat gjyqësore penale në Kosovë xhirohen me pamje e me zë nga mediat, përveç nëse gjyqtari vendos që xhirimi nuk lejohet, me anë të një aktvendimi të arsyetuar me shkrim. Para se një gazetari t'i mohohet qasja në gjykatore për arsye xhirimi, ai/ajo duhet të konsultojë udhëzuesit dhe/ose rregulloret administrative për këtë çështje, publikuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.<sup>20</sup>

---

<sup>15</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 315:

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>16</sup> Kuadri ligjor i Kosovës, Neni 41(2): <http://www.kryeministiks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

<sup>17</sup> Doracak Ligjor Bazë për Gazetarët në Kosovë - faqe 39-40

<sup>18</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 294:

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>19</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 296:

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>

<sup>20</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 301(3)

<https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Procedure%20Code.pdf>



## 2. Procedurat civile

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje përcakton një gamë të masave ligjore që mëtojnë të mbrojnë viktimat e dhunës në familje. Ai përkufizon dhunën në familje dhe marrëdhëniet familjare, shpjegon se cilat lloje të masave mbrojtëse dhe urdhrave ekzistojnë dhe procedurën që duhet ndjekur me qëllim të sigurimit të tyre.

Personat të cilët i nënshtrohen dhunës në familje gëzojnë të drejtën për urdhra mbrojtës, urdhra mbrojtës emergjent dhe urdhra mbrojtës të përkohshëm emergjent.<sup>21</sup> Urdhrat mbrojtës përfshijnë ndalimin e afrimit të viktimës nga ana e kryerësit të dhunës në familje,<sup>22</sup> largimin e kryerësit nga hapësira e banimit,<sup>23</sup> shoqërimin e viktimës së dhunës në familje me qëllim të marrjes së gjësendeve personale<sup>24</sup> dhe heqjen e përkohshme të së drejtës prindërore për kryerësin e dhunës në familje.<sup>25</sup>

Këto në vijim janë disa gjëra të rëndësishme që duhet të merren parasysh nga gazetarët:

- *A i është ofruar viktimës mbrojtja me kohë dhe e mjaftueshme?*
- *A është lëshuar lloji i duhur i urdhrit mbrojtës?*
- *Nëse urdhri mbrojtës është refuzuar, cili ka qenë arsyeja?*
- *A është trajtuar viktimat me respekt dhe ndjeshmëri?*
- *A ekzistojnë shërbime të mjaftueshme të përkthimit në strehimore, nëse viktimat është nga një komunitet joshumicë?*
- *A është efikas sistemi i referimit?*
- *A ekzistojnë hapësira të mjaftueshme dhe të duhura për fëmijët në strehimore?*
- *A financohet strehimorja mjaftueshëm dhe pandërprerë?*
- *A ofron strehimorja projekte të mjaftueshme rehabilitimi dhe integrimi?*
- *A trajtohen seriozisht pretendimet e viktimës?*
- *Nëse viktimat ka kërkesa të veçanta, a trajtohen ato?*

Strategjia e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna dhe Plani i veprimit 2016-2020 ofron udhëzime për gazetarët se si të raportojnë për rastet e dhunës në familje që trajtohen në procedurë civile, domethënë kërkesat për urdhër mbrojtje apo urdhër mbrojtje emergjente, si dhe trajton çështje të rëndësishme të tilla si mungesa e bashkëpunimit mes institucioneve që trajtojnë rastet e dhunës në familje, boshllëqet në sistemin e referimit dhe mungesën e infrastrukturës për të mbështetur viktimat.<sup>26</sup>

<sup>21</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 1.3: <http://www.assemblykosova.org/common/docs/liqiet/2010-182-eng.pdf>

<sup>22</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 5: <http://www.assemblykosova.org/common/docs/liqiet/2010-182-eng.pdf>

<sup>23</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 7: <http://www.assemblykosova.org/common/docs/liqiet/2010-182-eng.pdf>

<sup>24</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 8: <http://www.assemblykosova.org/common/docs/liqiet/2010-182-eng.pdf>

<sup>25</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 6.2: <http://www.assemblykosova.org/common/docs/liqiet/2010-182-eng.pdf>

<sup>26</sup> Strategjia për mbrojtje nga dhuna në familje dhe plani i veprimit 2016-2020, faqe 30: <https://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Strategjia%20Kombëtare%20e%20RK%20për%20mbrojtje%20nga%20dhuna%20në%20familje%202016-2020.pdf>

Vështrimi kritik është ndër detyrimet kryesore të shtypit dhe gazetarët nuk duhet të druhen nga bërja e kritikave për mangësitë e procedurave dhe/ose mjediseve.<sup>27</sup>

### 3. Viktimat e dhunës në familje

Dhuna në familje nuk është e kufizuar vetëm në keqtrajtim fizik dhe viktimat mund të pësojnë trauma mendore dhe emocionale. Dhuna në familje ndodh në kontekst familjar dhe pasojat negative zakonisht prekin fëmijët, edhe nëse ata në të vërtetë nuk janë dëshmitarë të dhunës. Fëmijët viktimat të dhunës në familjes janë më të rrezikuar nga zhvillimi i problemeve serioze emocionale, të sjelljes dhe të zhvillimit të mëtutjeshëm.

Viktimat e krimeve gëzojnë të drejtën për mbrojtje të veçantë të identitetit të tyre për arsye të sigurisë dhe privatësisë,<sup>28</sup> dhe informata duhet të publikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, si interesi publik.<sup>29</sup> Kjo është tepër e rëndësishme në rastet e dhunës në familje, kur viktimat potencialisht mund të pësojnë pasoja të rënda dhe potencialisht fatale nëse zbulohet identiteti i tyre. Gjatë raportimit, gazetarët duhet të sigurohen që siguria e viktimës të jetë një nga shqetësimet e tyre parësore dhe gjithnjë duhet të marrin parasysh pasojat e mundshme të dëmshme kur identifikojnë personat në rastet e dhunës në familje.

- *Identiteti i viktimës nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare nuk duhet të publikohet asnjëherë në asnjë rrethanë dhe ky kufizim vlen gjithashtu edhe për dëshmitarët dhe të pandehurit.*<sup>30</sup>
- *Identiteti i viktimës së përdhunimit nuk duhet të publikohet asnjëherë.*
- *Fotografitë e trupave të të vdekurve nuk duhet të publikohen asnjëherë.*<sup>31</sup>

Nëse publikimi i emrit të pandehurit apo të dyshuarit çon në identifikimin e viktimës, nëse për shembull janë të afërm, atëherë gazetari duhet të jetë shumë i kujdesshëm dhe të përmbahet nga publikimi i emrit të pandehurit/dyshuarit. Është punë e mediave që të gjykojnë vetë nëse publikimi i emrit të pandehurit ka gjasa të çojë në identifikimin e viktimës së veprës.<sup>32</sup> Informacioni që identifikon një mik apo i afërm të pandehurit/dyshuarit, i cili nuk ka lidhje me procedurat, nuk duhet të publikohet.

---

<sup>27</sup> Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës, neni I (5): [http://presscouncil.ks.org/wpcontent/uploads/2015/04/Statute\\_PCK\\_English.pdf](http://presscouncil.ks.org/wpcontent/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf)

<sup>28</sup> Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian, neni 8: [http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text\\_en.pdf](http://www.europarl.europa.eu/charter/pdf/text_en.pdf)

<sup>29</sup> Konventa për mbrojtjen e personave lidhur me përpunimin automatik të dhënave personale, 108/GDPR, neni 9: <https://rm.coe.int/1680078b37>

<sup>30</sup> Kodi i Mediave të Shkruara, neni VI (2): [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute\\_PCK\\_English.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf)

<sup>31</sup> Doracak Ligjor Bazë për Gazetarët në Kosovë- faqe 43

<sup>32</sup> R (Press Association) kundër Cambridge Crown Court [2012] EWCA Crim 2434, [2013] 1 WLR 1979, paragrafët 15-17

### 3.1. Parashtrimi i pyetjeve viktimave të dhunës në familje

Kur i parashtrojnë pyetje viktimës së dhunës në familje, gazetarët duhet të kenë parasysh si në vijim:

- *Viktimat të cilat vuajnë nga trauma mendore dhe emocionale mund të ndihen fajtorë apo përgjegjës për atë që kanë përjetuar dhe mund ta vënë në dyshim gjykimin e tyre;*
- *Gazetarët duhet të sigurojnë se ata nuk e pyesin viktimën nëse ka provokuar ose jo kryerësin, duke qenë se dhuna në familje ka të bëjë me pushtet dhe kontroll, e jo me hidhërim;*
- *Përveç nëse është drejtpërdrejtë pjesë e rastit, gazetarët nuk duhet të përqendrohen në atë nëse viktimë ka pirë apo ka marrë drogë ose jo - këto pyetje nuk i bëhen as viktimës së një vjedhjeje sepse e përjetësojnë fajësimin e viktimës;*
- *Fëmijët nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare nuk duhet të merren në intervistë apo fotografohen, pa pëlqimin e prindit apo të një të rrituri i cili është përgjegjës për fëmijën;<sup>33</sup>*
- *Nëse është e dukshme se viktimë nuk po ndjehet rehat, gazetari duhet të rivlerësojë pyetjet e tija duke qenë se tema të caktuara mund ta rishfaqin traumën e viktimës;<sup>34</sup>*
- *Raportoni për dhunën në familje në atë mënyrë që respekton të drejtën për dinjitet të mbijetuarit dhe jepni atyre aq kohë sa u nevojitet për ta treguar historinë e tyre.*
- *Vërtetoni me ta se e keni pëlqimin për të zbuluar elemente të historisë së tyre, dhe kurdoherë që është e mundshme, jepuni mundësinë për ta rishikuar kopjen para se ta publikoni atë.*

Gazetarët asnjëherë nuk duhet ta pyesin viktimën se pse nuk e kanë lënë partnerin e tyre, duke qenë se mund të ketë disa arsye legjitime përse viktimë ka qëndruar në marrëdhënie abuzive. Largimi është shpesh momenti më i rrezikshëm për viktimën dhe fëmijët e tyre, dhe dhuna dhe sulmet seksuale shtohen në mënyrë dramatike gjatë ndarjes. Kryerësit shpesh përdorin taktikat e manipulimit emocional për ta parandaluar viktimën që të largohet, duke i kërcënuar se do të lëndojnë fëmijët apo se do të bëjnë vetëvrasje. Varësia ekonomike është gjithashtu faktor i rëndësishëm pse viktimat shpesh nuk largohen dhe për shkak të taktikave të izolimit, shumë viktimë janë të shkëputura nga familja dhe miqtë dhe nuk kanë qasje në rrjetet mbështetëse.

---

<sup>33</sup> Kodi i Mediave të Shkruara , neni VI (1): [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute\\_PCK\\_English.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf)

<sup>34</sup> Kodi i Mediave të Shkruara , neni VII(2): [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute\\_PCK\\_English.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf)

# 4. Gjëra të rëndësishme që duhet të merren parasysh

## 4.1. Burimet

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që gazetarët të kenë parasysh burimet që i përdorin dhe është praktikë e zakonshme që ta përdorin policinë si burim parësor, pastaj fqinjët, miqtë dhe anëtarët e familjes. Sidoqoftë, gazetarët duhet gjithashtu të përfshijnë citime nga ekspertët e dhunës në familje, posaçërisht nga komunitetet ku ka ndodh dhuna në familje, duke qenë se analiza e dhunës mund të ndihmojë në largimin e miteve dhe keqkuptimeve. Nëse mbrojtësit e viktimave të dhunës në familje janë burimi, gazetarët duhet të sigurohen që do t'i pyesin për informata mbi shërbimet që janë në dispozicion në zonat e ndryshme dhe të pyesin për kontekstin.

Nëse policia është burimi i informatave, gazetarët duhet të sigurohen se do të përcjellin rastin me policinë dhe se do të parashtrojnë pyetje për përparimin e shënuar nga policia; megjithatë informatat që ata i japin shpeshherë mund të jenë të kufizuara. Nëse mbështeteni tek miqtë/anëtarët e familjes/fqinjët si burim të informatave, është me rëndësi të mbahet në mend se ata shpesh janë të anshëm për shkak të marrëdhënies së tyre të ngushtë me viktimën apo kryerësin. Ndonëse ata mund të japin mendime të dobishme dhe njohuri për gjendjen lidhur me historinë dhe kontekstin, mendimi i tyre nuk duhet të paraqitet si fakt dhe gazetarët duhet të sigurohen që ta bëjnë dallimin në mënyrë të qartë mes faktit dhe mendimit.<sup>35</sup>

Nëse burimet japin informata me kusht që identiteti i tyre të jetë i mbrojtur, atëherë burimi duhet të mbahet gjithmonë anonim.<sup>36</sup> Në përgjithësi, gazetarët në Kosovë gëzojnë të drejtën për të mbrojtur burimet e tyre dhe për të heshtur, pa mbajtur përgjegjësi penale.<sup>37</sup> Për më tepër, gazetarët nuk mund të detyrohen që të zbulojnë burimin e tyre të informatave apo që të japin materialet që mund ta zbulojnë: identitetin e burimit, natyrën apo prejardhjen e informatave të dhëna, identitetin e autorit të një teksti apo prodhimi audio-vizual, ose përmbajtjen e një dokumenti të informatave nëse ai mund të çojë në identifikimin e burimit.<sup>38</sup> Zbulimi i burimeve mund të shkurajojë qytetarët nga dhënia e informacionit për gazetarët dhe mund të ndikojë në aftësinë e gazetarëve për të raportuar për drejtësinë dhe për ta përmbushur elementin e gjykimit publik të së drejtës për gjykim të drejtë.

---

<sup>35</sup> Kodi i Mediave të Shkruara , neni III(4): [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute\\_PCK\\_English.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf)

<sup>36</sup> Kodi i Mediave të Shkruara , neni III(3): [http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute\\_PCK\\_English.pdf](http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf)- Ky detyrim ekziston pa marrë parasysh nëse burimi shprehimisht ka kërkuar ose jo fshetësi.

<sup>37</sup> Kodi Penal, neni 38: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>38</sup> Ligjet e Kuvendit të Kosovës: Ligji nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, nenet 4.1.1 – 4.1.4: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/liqjet/Law%20on%20the%20protection%20of%20the%20journalism%20sources.pdf>

Konsiderohet si e nevojshme që gazetari ta identifikojë burimin vetëm nëse:

- *Mund të përcaktohet se masat e tjera të arsyeshme për zbulim nuk ekzistojnë apo se interesi legjitim për zbulim në mënyrë të qartë është më i rëndësishëm se interesi publik për moszbulim;*<sup>39</sup>
- *Vetëm me kërkesë të gjykatës kompetente dhe vetëm nëse zbulimi i identitetit të burimit të informacionit është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz të integritetit fizik me pasojë vdekjen të një ose më shumë personave.*

## 4.2. Dëshmitarët

Është e rëndësishme që të jemi të kujdesshëm gjatë raportimit për dëshmitarët e përfshirë në rastet e dhunës në familje. Në cilindo fazë të procedurave, gjyqtari mund të urdhërojë masa mbrojtëse për dëshmitarin nëse përcaktohet se ekziston një rrezik serioz dhe se masa mbrojtëse është e nevojshme për ta parandaluar rrezikun serioz.<sup>40</sup> Gazetarët duhet gjithashtu të jenë të kujdesshëm edhe për dëshmitarët të cilët nuk janë nën urdhra mbrojtës, dhe asnjëherë nuk duhet ta zbulojnë identitetin e tyre në rast se kjo përbën rrezik për jetën a sigurinë e tyre.

Zbulimi i informatave për identitetin apo të dhënat personale të një personi nën mbrojtje, në procedurë penale apo në një program të veçantë të mbrojtjes pa autorizim përbën vepër penale që dënohet me burgim deri në pesë vjet.<sup>41</sup> Nëse vepra penale rezulton me pasojë të rënda për personin e mbrojtur ose procedura penale bëhet e pamundur ose vështirësohet në masë të madhe, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.<sup>42</sup>

Identiteti i dëshmitarëve mund të zbulohet vetëm për arsye si në vijim:<sup>43</sup>

- *Dëshmitari është i aftë dhe ka dhënë pëlqimin për ta zbuluar identitetin e tij/saj;*
- *Identifikimi i tyre është çështje e interesit publik;*
- *Dëshmia tashmë është dhënë publikisht.*

---

<sup>39</sup> Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, CM/Rec(2000)7: Parimi 3(b) për 'kufizimet ndaj së drejtës së moszbulimit': [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016805e2fd2](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805e2fd2)

<sup>40</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 221: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>41</sup> Kodi Penal, neni 400: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>42</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 400: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>43</sup> Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, CM/Rec(2003)13: Parimi 16 për 'mbrojtjen e dëshmitarëve': [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016805df617](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805df617)

### 4.3. E drejta për gjykim të drejtë

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që gazetarët të marrin parasysh të drejtat e njeriut të të pandehurit, dhe prezumimi i pafajësisë është thelbësor në lidhje me këtë.<sup>44</sup> Nëse ka ndonjë dyshim lidhur me faktet relevante për rastin, ato duhet gjithmonë të interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tyre.<sup>45</sup> Kjo e drejtë zbatohet për të gjithë të pandehurit në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh se a janë të profilit të lartë apo të ulët, dhe pa marrë parasysh se cila është vepra penale e pretenduar.

Personi i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.<sup>46</sup> Kjo mund të bëhet thjesht duke shkruar fjalën 'pretenduar' në fjali, si për shembull: 'I pandehuri **pretendohet** se ka sulmuar viktimën', në vend të 'i pandehuri ka sulmuar viktimën'. Shtypi mund ta quajë personin kryerës nëse ai/ajo e ka pranuar atë dhe kur ka prova se ai/ajo e ka kryer veprën në mënyrë publike.<sup>47</sup> Megjithatë gazetarët duhet të sigurohen që të bëjnë baraspeshë mes prezumimit të pafajësisë dhe dhënies së arsyetimeve për kryerësin.

Është po ashtu e rëndësishme që gazetarët të sigurojnë përdorimin e terminologjinë e duhur kur përshkruajnë kryerësin, duke qenë se një person i "dyshuar" për vepër penale gëzon status tjetër nga personi i "akuzuar" për vepër penale. Të dyshuarit zakonisht arrestohen nga Policia para se të përfshihet Prokuroria dhe personat e arrijnë statusin e të "akuzuarit" pasi që ndaj tyre të jetë ngritur aktakuza dhe pasi që të ketë nisur procedura penale. Shtypi duhet të publikojë emrat, fotografitë dhe informacionin që mundëson identifikimin e të dyshuarve, vetëm nëse interesi legjitim i publikut është më i lartë se interesat e personave që vlen të mbrohen.

---

<sup>44</sup> Sipas nenit 14 (2) të PNDCP dhe nenit 6 (2) të KEDNJ, qytetarët e akuzuar me vepër penale gëzojnë të drejtën për tu konsideruar të pafajshëm derisa të shpallen fajtor, kuadri ligjor i Kosovës, neni 31(5)

E drejta kundër vetë inkriminimit: Sipas nenit 14 (3) të PNDCP dhe Kodit të Procedurës Penale të Kosovës: Neni 3

<sup>45</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 3.2: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>,

Kuadri ligjor i Kosovës, neni 31: <http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

<sup>46</sup> Kuadri ligjor i Kosovës, Neni 5: <http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

Kodi Penal, neni 3: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>47</sup> Kodi i Shtypit Gjerman, pjesa 13 për prezumimin e pafajësisë: Udhëzimi 13.1 për paragjykimin: [http://www.presserat.de/fileadmin/user\\_upload/Downloads\\_Dateien/Pressekodex2017english.pdf](http://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex2017english.pdf)



## 5. Media dhe dhuna në familje

Mediat e lajmeve janë forcë e fuqishme në formimin e perceptimit të publikut rreth dhunës në familje dhe mbulimi nga mediat mund të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes, mirëkuptimit dhe dhembshurisë dhe mund të ndihmojë në mobilizimin e komuniteteve në marrjen e masave për ta parandaluar atë.

Një studim i kohëve të fundit ka krijuar lidhje të qarta ndërmjet raportimit të mediave dhe mënyrës se si komuniteti pritës e sheh çështjen në fjalë.<sup>48</sup> Prandaj, është e domosdoshme që gazetarët të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se nuk janë duke shpërndarë materiale të pasakta, çorientuese, që e fajësojnë viktimën ose materiale të pandjeshme në lidhje me dhunën në familje.

Pavarësia dhe paanshmëria janë dy nga parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor,<sup>49</sup> dhe këto duhet të respektohen nga gazetarët dhe të pasqyrohen në publikimet e tyre. Gazetarët duhet të veprojnë në mënyrë të përshtatshme gjatë hetimeve të policisë dhe procedurave në vazhdim, me qëllim që të shmangin rrezikimin e një hulumtimit objektiv. Gazetarët profesionistë nuk mund të raportojnë në mënyrë etike histori që përfshijnë familjen ose miqtë e tyre për shkak të rrezikut të paragjyqimit dhe/ose konfliktit të interesit.<sup>50</sup> Ata gjithashtu duhet të përmbahen nga marrja e punës nga një individ që punon për gjykatën ose policinë,<sup>51</sup> pasi kjo paraqet konflikt interesi dhe parandalon raportimin e balancuar. Gazetarët duhet gjithashtu të mbesin të balancuar duke u siguruar që të mos janë të ndikuar nga pranimi i dhuratave, ftesave ose zbritjeve të çmimeve. Ata duhet të insistojnë që informacioni të jepet pa marrë parasysh pranimin e dhuratës ose ftesës dhe nuk duhet të pranojnë asnjë gjë që ka një vlerë të pazakontë ose të tepërt.<sup>52</sup>

### 5.1. Sigurimi i kontekstit

Nuk mjafton thjesht të raportohen fakte; gazetarët duhet të përfshijnë kontekstin në raportimin e tyre, pasi kjo do të lehtësojë të kuptuarit për marrëdhëniet e pushtetit shoqëror dhe strukturat që lejojnë ndodhjen e niveleve të larta të abuzimit. Abuzimi shpesh ndodh në mjedise shumë kontrolluese, dhe zakonisht ka aspekte të konteksteve sociale, ekonomike dhe politike që kontribuojnë në mjedise të tilla, pasi ato ndikojnë në sjelljet individuale.<sup>53</sup>

---

<sup>48</sup> "National Child Protection Clearing House", Roli i mas-medias në lehtësimin e edukimit të komunitetit dhe strategjitë për parandalimin e abuzimit të fëmijëve, faqe 6: <https://aifs.gov.au/cfca/sites/default/files/publication-documents/issues16.pdf>

<sup>49</sup> Kuadri Ligjor i Kosovës, Neni 102: <http://www.kryeministriks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf>

<sup>50</sup> Doracak Ligjor Bazë për Gazetarët në Kosovë, faqe 41

<sup>51</sup> Doracak Ligjor Bazë për Gazetarët në Kosovë, faqe 41

<sup>52</sup> Kodi i Shtypit Gjerman, Neni 15 mbi Trajtimin Preferencial: Udhëzuesi 15.1 për ftesat dhe dhuratat:

[http://www.presserat.de/fileadmin/user\\_upload/Downloads\\_Dateien/Pressekodex2017english.pdf](http://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex2017english.pdf)

<sup>53</sup> Analizimi i sjelljeve të dhunës në familje në kontekstet e tyre: Dhuna si vazhdim i strategjive sociale me mjete të tjera, Bernard Guerin, *Universiteti i Australisë Jugore* Marcela de Oliveira Ortolan Universiteti i Londrës, faqe 6: <http://journals.uic.edu/ojs/index.php/bsi/article/view/6804>

Gratë janë në rrezik më të madh të vuajtjes nga dhuna në familje, veçanërisht në kontekstin e abuzimit nga partneri, që është forma më e përhapur e abuzimit. Dhuna në familje si formë e dhunës gjinore është veçanërisht problematike në Kosovë, pasi hulumtimet e ndërmarra treguan se ajo kryesisht si cak i ka gratë për shkak të gjinisë së tyre.<sup>54</sup> Gazetarët duhet të sigurohen që të mos injorojnë ose të nënvlerësojnë aspektet gjinore të dhunës në familje dhe aspektin se ajo shfaqet në mënyrë joproporcionale kundër grave ku kryerësit janë kryesisht meshkuj. Gazetarët mund të japin kontekstin duke identifikuar faktorët e caktuar të rrezikut, duke siguruar informacion mbi shpeshhtësinë, dinamikën, ndikimet dhe ligjet rreth dhunës në familje.

Hulumtimet e ndërmarra në 2014 dhe 2016<sup>55</sup> kanë treguar se ka pasur shumë forma të abuzimit që publiku nuk i konsideron si dhunë në familje, me 48.2% të të anketuarve që deklarojnë se kontrollimi se ku mund ose nuk mund të shkojë një anëtar i familjes nuk ishte formë e dhunës.<sup>56</sup> Mendimet e burrave dhe grave nuk ndryshojnë në mënyrë drastike,<sup>57</sup> duke treguar se shumë viktime të dhunës në familje nuk do të kuptojnë se janë duke iu nënshtruar abuzimit. Viktimat meshkuj në përgjithësi janë më tepër viktime të anëtarëve tjerë të familjes sesa bashkëshortëve,<sup>58</sup> dhe kanë më pak gjasa të raportojnë abuzimin. Mungesa e edukimit në lidhje me dinamikën gjinore dhe stereotipet e dhunës në familje dhe natyrën e saj kontrolluese mund të jep kontribut të rëndësishëm në stigmatizim. Shumica e strategjive që përdoren nga kryerësit nuk do të funksiononin pa pranimin shoqëror dhe është konteksti më i gjerë shoqëror dhe politik që e mundëson vazhdimin e kësaj.<sup>59</sup> Gazetarët gjithashtu mund të hedhin dritë mbi këto kontekste duke theksuar se vetëm 10% e incidenteve janë raportuar dhe se ekzistimi i dhunës në familje nuk duhet të nënvlerësohet.

Në përgjithësi, etnia, feja ose përkatësia e një grupi minoritar nuk duhet të përmenden për të siguruar që nuk do të ketë asnjë përgjithësim dhe paragjykim diskriminues përveç nëse është në interes legjitim të publikut të gjerë.<sup>60</sup> Derisa dhuna në familje ekziston në çdo komunitet dhe çdo nivel shoqëror, vlerat kulturore dhe shoqërore kontribuojnë në kryerjen e dhunës në familje dhe për këtë arsye nuk mund të injorohen pasi që ato janë në interesin legjitim të publikut.

---

<sup>54</sup> Siguria fillon në shtëpi, hulumtimi për të informuar Strategjinë e Parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë, faqja 7: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130715145730743.pdf>

<sup>55</sup> Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje në Kosovë, 2016, faqe 5: <http://ir-see.eu/wp-content/uploads/2016/10/web-Kosovo-1.pdf>

<sup>56</sup> Siguria fillon në shtëpi, hulumtimi për të informuar Strategjinë e Parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë, faqja 13-15: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130715145730743.pdf>

<sup>57</sup> Siguria fillon në shtëpi, hulumtimi për të informuar Strategjinë e Parë Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Dhunës në Familje në Kosovë, faqja 13-14: <http://www.womensnetwork.org/documents/20130715145730743.pdf>

<sup>58</sup> Mbrojtja e viktimave të dhunës në familje në Kosovë, 2016, faqe 5: <http://ir-see.eu/wp-content/uploads/2016/10/web-Kosovo-1.pdf>

<sup>59</sup> Analizimi i Sjelljeve të Dhunës në Familje në kontekstet e tyre: Dhuna si vazhdim i strategjive sociale me mjete të tjera, Bernard Guerín, *Universiteti i Australisë Jugore* Marcela de Oliveira Ortolan Universidade Estadual de Londrina, faqe 22: <http://journals.uic.edu/ojs/index.php/bsi/article/view/6804>

<sup>60</sup> Kodi i Shtypit Gjerman, Neni 12 mbi Diskriminimin: Udhëzuesi 12.1 rreth Raportimit mbi Krime: [http://www.presserat.de/fileadmin/user\\_upload/Downloads\\_Dateien/Pressekodex2017english.pdf](http://www.presserat.de/fileadmin/user_upload/Downloads_Dateien/Pressekodex2017english.pdf)

Nëse dhuna në familje është më e përhapur në disa komunitete ose rajone atëherë kjo duhet të përfshihet në storje, dhe statistikak janë të dobishme për të siguruar kontekstin.

## Konsiderata të rëndësishme

Është shumë e rëndësishme që **gazetarët të marrin në konsideratë aspektet vijuese:**

- *Senzacionalizimi dhe zbulurimi i fakteve për një storje më goditëse është joetik dhe i pandjeshëm dhe nuk i shërben interesave të viktimës apo publikut;*
- *Gjithmonë përdorni fjalën 'dhuna në familje', sepse nuk duhet të minimizohet si thjesht 'mosmarrëveshje' ose 'sulm', pasi kjo minimizon situatën dhe traumën e viktimës;*
- *Nëse dhuna në familje ka ndodhur në një zonë të vogël ku identifikimi mund të ndodhë me lehtësi, këshillohet të fshihet emri i qytetit ose fshatit, pasi kjo mund ta rrezikojë viktimën;*
- *Gazetarët duhet t'i qartësojnë marrëdhëniet ndërmjet palëve në fjalë dhe të specifikojnë nëse ata janë çift ose të afërm;*
- *Njiheni faktin që ky është krim që ka si viktimën ashtu edhe kryerësin - Dhuna në familje nganjëherë raportohet me tituj si 'Gruaja sulmuar', duhet të njihet si krim;*
- *Në shumicën e rasteve dhuna në familje kryhet nga dikush i njohur për të mbijetuarin;*
- *Dhuna seksuale e shkaktuar nga një bashkëshort ose partner është prapë dhunë seksuale dhe nuk duhet të mohohet si e tillë. Të qenit në marrëdhënie intime nuk do të thotë automatikisht se ka pasur pëlqim.*
- *Është thelbësore që gazetarët të sigurohen se i kanë kontrolluar faktet për çdo pretendim të publikuar, të sigurojnë nivel sa më të lartë të saktësisë që është e mundur dhe të përmbahen nga paraqitja e thashethemeve si prova materiale.*

## 6. Informata mbi strehimoret dhe linjat ndihmëse

Aktualisht ekzistojnë 7 strehimore të licencuara në Kosovë që ofrojnë vend të sigurt ku viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre iu ofrohet strehim i përkohshëm, siguri, ndihmë dhe shërbime të tjera.<sup>61</sup> Ato janë të vendosura në: Gjilan, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë Jug, Ferizaj dhe Novobërdë (2018).<sup>62</sup> Aktualisht nuk ekzistojnë strehimore që veprojnë në komunat veriore të Kosovës. Shërbimet sociale dhe familjare gjithashtu mund të kontraktohen nga komunat tek organizatat joqeveritare,<sup>63</sup> dhe shërbimet mjekësore janë gjithashtu në dispozicion për ata që përjetojnë dhunë në familje.<sup>64</sup>

Policia e Kosovës është e detyruar t'i referojë dhe t'i dërgojë viktimat në strehimore, megjithatë referimi mund të bëhet edhe nga institucionet tjera, ose viktimat mund ta bëjnë këtë sipas vullnetit të tyre.<sup>65</sup> Referimi dhe ofrimi i asistencës për viktimat duhet të kryhet pa asnjë diskriminim në bazë të gjinisë, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës sociale ose kombësisë, pasurisë, lindjes apo ndonjë statusi tjetër.<sup>66</sup> Mirëpo, përkundër faktit që shumë pjesëtarë të stafit të strehimores flasin rrjedhshëm të dyja gjuhët zyrtare, strehimoret nuk ofrojnë informata në gjuhë tjera përveç në gjuhën shqipe, duke kufizuar qasjen për shumë nga komunitetet joshumicë në Kosovë. Djemtë mbi moshën 12 vjeçare nuk mund t'i shoqërojnë nënat e tyre, dhe burrat nuk mund të referohen në strehimore, edhe nëse janë viktimat të dhunës në familje.

Gjatë 48 orëve të para të pranimit, strehimoret zbatojnë 'periudhën e reflektimit', duke siguruar qasje të menjëhershme në strehim të sigurt ku zbatohen dhe planet individuale të riintegrit. Derisa janë në strehimore viktimave u sigurohet veshmbathje, ushqim, kujdes mjekësor themelor, këshillim psiko-social, këshilla ligjore (duke përfshirë plotësimin e kërkesës për urdhër mbrojtjeje për viktimën), aktivitete rekreative dhe trajnuese dhe 24 orë sigurim dhe përkujdesje. Viktimat me nevoja të veçanta ose aftësi të kufizuara gjithashtu kanë të drejtën e trajtimit të veçantë, dhe strehimoret priten të shoqërojnë viktimën në gjykatë, në stacionin e policisë dhe në spital dhe njësinë e mjekësisë ligjore.

---

<sup>61</sup> Agjencia për Barazi Gjinore: Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Prishtinë, 2013), faqe 10.

<sup>62</sup> Strehimorja e Novobërdës menaxhohet nga komuniteti joshumicë serb; megjithatë, për shkak të procesit të vazhdueshëm të licencimit nuk ka qenë funksionale, pasi shumica e punëtorëve socialë të kualifikuar serbë kanë marrë kredencialet e tyre profesionale në Serbi.

<sup>63</sup> Këshilli i Evropës, Shërbimet mbështetëse për identifikimin e viktimave të dhunës ndaj grave në Kosovë (Prishtinë 2017), faqe 28.

<sup>64</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 27: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

<sup>65</sup> Ministria e Drejtësisë Strategjia për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, (Prishtinë, 2016), faqe 22.

<sup>66</sup> Agjencia për Barazi Gjinore: Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Prishtinë, 2013), faqe 24.

Masat mbrojtëse të trajtimit psiko-social mund t'i lëshohen kryerësit në kombinim me ndonjë masë tjetër parandaluese për të shmangur sjelljen e tyre të dhunshme dhe për të parandaluar përsëritjen e dhunës në familje.<sup>67</sup> Kryerësi mund t'i nënshtrohet edhe trajtimit mjekësor të detyrueshëm nga alkooli dhe varësia e substancave psikotrope kur ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje.<sup>68</sup> Aktualisht, strehimoret përballen me mungesë të financimit të qëndrueshëm, gjë që përbën sfidën kryesore për funksionimin e tyre të përditshëm dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat.<sup>69</sup>

Aktualisht ekzistojnë 40 Qendra për Punë Sociale në Kosovë, të cilat janë institucione publike profesionale që veprojnë në nivel komunal, të cilat ofrojnë një numër shërbimesh sociale për njerëzit në nevojë, veçanërisht për të miturit dhe individët të cilëve u mungon zotësia e veprimi.<sup>70</sup> Këto qendra sigurojnë mbrojtje sociale me dy funksione themelore: ofrimin e shërbimeve sociale profesionale për individët dhe familjet në nevojë sociale dhe sigurimin e skemave të përfitimeve me para të gatshme (shpërndarja e ndihmës sociale për familjet e varfra). Ky kujdes administrohet në formën e shërbimeve të përkujdesit rezidencial, ditor dhe në komunitet.<sup>71</sup> Në lidhje me dhunën në familje, qendrat ofrojnë asistencë në disa mënyra, përfshirë kryerjen e vlerësimit të nevojave, dorëzimin e kërkesave për urdhra e mbrojtjes, ofrimin e këshillimit psiko- social dhe ligjor<sup>72</sup> për viktimat, dhe merren me mbrojtjen dhe garancitë për fëmijët.

Gjithashtu është e dobishme të jepni informata në lidhje me linjën ndihmëse: **08001112** , e cila u ofron ndihmë viktimave të krimit, duke u dhënë atyre informacionin e nevojshëm dhe numrat e kontaktit, përfshirë informacionin mbi dhunën në familje, abuzimin seksual dhe trafikimin.<sup>73</sup> Kjo linjë ndihmëse i jep mundësi publikut të gjerë dhe viktimave që të raportojnë vepra penale që lidhen me dhunën në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

---

<sup>67</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 4: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/2010-182-eng.pdf>

<sup>68</sup> Ligji nr. 03/L -182 mbrojtje nga dhuna në familje, Kuvendi i Kosovës, neni 9: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/liqjet/2010-182-eng.pdf>

<sup>69</sup> Institucioni i Avokatit të Popullit luan rol kyç në mbështetjen e viktimave të dhunës në familje përmes adresimit të mangësive në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga institucionet publike në Kosovë

<sup>70</sup> OSBE, Katalogu i këshillave dhe ndihmës për viktimat e dhunës në familje,

<https://www.osce.org/kosovo/88708?download=true>

<sup>71</sup> Ky informacion gjithashtu mund t'i ofrohet audiencave të ndryshme, si mediat, institucionet, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe publiku i gjerë.

<sup>72</sup> Save The Children, Vlerësimi i Nevojave për Qendrën për Punë Sociale në tri komunat e Kosovës, në Prishtinë, Ferizaj dhe Klinë, faqe 16: [https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Need %20Assessment%20for%20Centre%20for%20Social%20Work%20in%20three%20municipalities%20of%20Kosovo%2C%20in%20Pristina%2C%20Ferizaj%20Pastaj%20Klina.pdf](https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Need%20Assessment%20for%20Centre%20for%20Social%20Work%20in%20three%20municipalities%20of%20Kosovo%2C%20in%20Pristina%2C%20Ferizaj%20Pastaj%20Klina.pdf)

<sup>73</sup> Këshillimi ligjor është gjithashtu në dispozicion përmes zyrave të ndihmës juridike falas nëpër qarqe, të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat që kualifikohen për të, duke përfshirë përfaqësimin para gjykatave ose organeve administrative.

<sup>74</sup> Ky informacion gjithashtu mund t'i ofrohet audiencave të ndryshme, si mediave, institucioneve, organizatatve ndërkombëtare, OJQ-ve dhe publikut të gjerë.

Gazetarët mund të ofrojnë mbështetje jo vetëm për viktimat, por edhe për miqtë, familjet dhe bashkëpunëtorët e viktimave të dhunës në familje, duke ofruar informacion rreth veprimeve të duhura që duhet ndërmarr. Ky informacion mund të sigurohet në fund të një artikulli, dhe është e këshillueshme që gjithmonë të përfshijë numrin e linjës ndihmëse në të gjitha publikimet që lidhen me dhunën në familje, pasi është e zakonshme që viktimat të ndjehen të ndrojtura për kontaktimin e policisë.

Për shembull, këto në vijim mund të kopjohen dhe ngjiten në një publikim:

*“Nëse dyshoni se dikush që e njihni është duke vuajtur nga dhuna në familje atëherë është e këshillueshme që të telefononi numrin pa pagesë të linjës ndihmëse: **080011112** i cili ofron këshilla dhe referim tek mbrojtësi i viktimave dhe Zyra e Ndihmës në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit, për ndihmë dhe mbrojtje. Nëse besoni që ju ose dikush që njihni është në rrezik të menjëhershëm nga partneri ose të afërmit e tyre është e këshillueshme që të telefononi policinë, e cila mund të kontaktohet në raste urgjente në numrin 112. Tani ekzistojnë 7 strehimore të licencuara në mbarë Kosovën që ofrojnë mbrojtje dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje”.*



**UNITED AGAINST  
DOMESTIC VIOLENCE**